

RREGULLORE NR. 1999/16

UNMIK/RREG/1999/16

6 nëntor 1999

PËR THEMELIMIN E AUTORITETIT QENDROR FISKAL TË KOSOVËS DHE  
ÇËSHTJE TË TJERA LIDHUR ME TË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë të datës 25 korrik 1999,

Me qëllim të themelimit të Autoritetit Qendror Fiskal në Kosovë dhe çështjeve të tjera lidhur me të,

Shpall sa vijon:

Neni 1

AUTORITETI QENDROR FISKAL

Autoriteti Qendror Fiskal, duke vepruar nën autoritetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, është përgjegjës për drejtimin e gjithanshëm financiar të Buxhetit të Kosovës dhe buxheteve që janë në përgjegjësinë e komunave, të cilat së bashku formojnë Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Ky buxhet hartohet, miratohet dhe realizohet i ndarë nga buxheti i Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të cilin e miraton Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

Neni 2

## FUNKSIONET

2.1 Autoriteti Qendror Fiskal, pas konsultimit me autoritetet përgjegjëse qendrore dhe komunale për shpenzime, i rekomandon Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me:

(a) Formulimin e një strategjie të përgjithshme fiskale për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, në dritën e kushteve makroekonomike dhe ndikimin që politika fiskale mund të ketë në kushtet ekonomike;

(b) Hartimin e programit të të ardhurave publike dhe shpenzimeve për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe formulimin e planeve për kontrollin dhe realizimin e shpenzimeve sipas këtij programi të të ardhurave dhe shpenzimeve;

(c) Formulimin e politikave për krijimin dhe mbledhjen e të ardhurave, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në to, tatimet direkte dhe indirekte, detyrimet doganore dhe akcizat, tatimin mbi shitjen, pagesat për shërbimet dhe kontributet e donatorëve;

(d) Kontrollin dhe realizimin e mbledhjes së të ardhurave dhe shpenzimet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës;

(e) Krijimin e një kontrolli të fortë të brendshëm financiar për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe,

(f) Menaxhimin e llogarive bankare të Fondit të Konsoliduar të Kosovës.

2.2 Autoriteti Qendror Fiskal:

(a) Harton Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe ia paraqet këtë buxhet Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për miratim dhe shpallje me rregullore.

- (b) Siguron që buxhetet e komunave të hartohen, miratohen dhe realizohen nga Administratorët Rajonalë në përputhje me kushtet e vlerësuara makroekonomike dhe me Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës;
  
- (c) Regjistron dhe i raporton Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për shpenzimet dhe të ardhurat e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës;
  
- (d) Kujdeset për krijimin e një mjedisi teknologjik informativ në mbështetje të funksioneve të veta dhe,
  
- (e) Kryen funksione të tjera të nevojshme për aktivitetet e sipërpërmendura.

Neni 3

#### DREJTUESI I AUTORITETIT QENDROR FISKAL

3.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron Drejtuesin e Autoritetit Qendror Fiskal, i cili, si drejtuesi kryesor ekezekutiv dhe nën mbikëqyrjen e përditshme të Zëvendëspërfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Rindërtim Ekonomik, Rimëkëmbje dhe Zhvillim është përgjegjës për menaxhimin e Autoritetit Qendror Fiskal dhe për zbatimin e funksioneve që i janë besuar atij.

3.2 Drejtuesi i Autoritetit Qendror Fiskal punëson punonjësit, organizon dhe administron Autoritetin Qendror Fiskal dhe nxjerr udhëzime administrative e procedura operative lidhur me administrimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e Autoritetit Qendror Fiskal.

Neni 4

#### BUXHETI I KONSOLIDUAR I KOSOVES

4.1 Viti fiskal është vit prej 12 muajsh, duke filluar më një janar dhe duke mbaruar më tridhejetë e një dhjetor të çdo viti kalendarik, nëse Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm nuk vendos ndryshe.

4.2 Drejtuesi i Autoritetit Qendror Fiskal hap dhe mban një apo më shumë llogari bankare për marrjen, ruajtjen, pagimin apo përcjelljen e parave të mbledhura a të pranuar që kanë të bëjnë me Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

4.3 Paratë e mbledhura apo të pranuar përbëjnë Fondin e Konsoliduar të Kosovës, pavarësisht nëse këto para janë marrë fillimisht në Zyrat e Pagesave në Kesh të Shërbimit të Pagesave Publike të Kosovës apo në llogaritë bankare. Përsa i përket fondeve të pranuar nga Fondi i Besur (Trust Fund) për Misionin e Administratës së Përkohshme të KB-së, mënyra e ndarjes dhe raportimit lidhur me transferet do të përcaktohet nga Kontrollori i Kombeve të Bashkuara dhe Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

4.4 Asnjë shpenzim nuk mund të bëhen nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës pa u miratuar me një rregullore të shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 5

#### KONTROLI I PAVARUR FINANCIAR

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm siguron krijimin e kontrollit të pavarur financiar për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Revizorët i raportojnë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 6

#### PERSONELI DHE POLITIKA E PUNËSIMIT

Drejtuesi i Autoritetit Qendror Fiskal duhet të zbatojë një politikë jodiskriminuese punësimi me qëllim që përbërja e personelit të AQF-së të pasqyrojë natyrën shumetnike të bashkësive të Kosovës.

Neni 7

## LIGJI NË FUQI

Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë të legjislacionit në fuqi që bie në kundërshtim me këtë rregullore.

Neni 8

## ZBATIMI

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhresa administrative për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 9

## HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi më 6 nëntor 1999.

Bernard Kouchner,

Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm